



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2024:033603

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05863258

**C.nr.549/2015**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICA**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “.... Group A.....” Sh.A., adresa Rr. .... pn, Pajton Prishtinë, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson A.A, kundër të paditurit D. (E.) G., me vendbanim të fundit në Rr.S.... G. Mitrovicë, tani me adresë të pa njohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.Bedri Miftari me seli ne Mitrovicë, me bazë kontesti: Rimbursim i borxhit, vlera e kontesti 1.200,00€, duke vendosur lidhur me kërkesën për shpenzime e parashtruar nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, jashtë seancës, me datë, 21.06.2024 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**DETYROHET** paditësja Kompania e Sigurimeve “.... Group A.....” Sh.A., adresa Rr. .... pn, Pajton Prishtinë , që në emër të shpenzimeve të procedurës për përfaqësues të përkohshëm të të paditurit të paguaj shumën prej, 540.00 €, avokatit Bedri Miftari nga Mitrovica, në xhirollogarinë bankare, nr..... pranë B..... Bankë, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi e nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj gjykate paditësja me dt. 05.10.2015, ka parashtruar padi, kundër te paditurit D. (E.) G., me vendbanim të fundit në Rr.S.... G. Mitrovicë, me bazë juridike, rimbursim dëmi.

Meqenëse për të paditurit gjykata nuk ka mundur të bij në kontakte, në mungese të adresës se saktë të vendbanimit ose të vendqëndrimit, ku paditësja me dt. 08.02.2018 përmes parashtrësë e ka njoftuar gjykatën se nuk ka adresë të re për të paditurin dhe i ka propozuar gjykatës caktimin e përfaqësuesit te përkohshëm konform nenit 79 të LPK-së, ku të gjitha shpenzimet do ti bartë paditësja.

Sipas propozimit të palës paditëse, e në mbështetje të dispozitës nga neni, 79.3, pika a) të LPK-së, Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin e datës 11.09.2018, të paditurit D. (E.) G., me vendbanim të fundit në Rr.S.... G. Mitrovicë , tani me adresë të panjohur, i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Bedri Miftari, avokat në Mitrovicë.

Pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e seancës gjyqësore, gjykata ka mbajtur seancat me dt. 07.06.2024, ku për palën paditëse ka prezantuar i autorizuari i te njëjtës A.A, ndërsa për të paditurin përfaqësuesi i përkohshme Bedri Miftari avokat në Mitrovicë, i caktuar nga ana e gjykatës.

Përfaqësuesi i përkohshme i të paditurit Bedri Miftari avokat në Mitrovicë, me datën 07.06.2024, ka kërkuar nga gjykata që të detyroje palën paditëse që të bëjë pagesën e

shpenzimeve për përfaqësimin nga përfaqësuesi i përkohshme, dhe atë për kater seanca gjyqësore nga 135 euro apo ne total 540.00 euro, sipas Tarifës se Odës se Avokateve të Kosovës, duke potencuar pretendime të tjera lidhur me kërkesën për shpenzimet si përfaqësues i përkohshme, duke i propozuar gjykatës që të bie aktvendim me të cilin do të detyrohet paditësi që ta përmbush detyrimin e tij, e pagesa të behët në emër të përfaqësuesit të përkohshme, avokatit Bedri Miftari nga Mitrovica, në xhirollogarinë bankare, nr.1950001826031194 pranë BKT Bankë .

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktvendim, duke e detyruar paditësin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës për përfaqësuesin e përkohshme, pasi që përfaqësuesi i përkohshme i të paditurit, Bedri Miftari avokat nga Mitrovica, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar - specifikuar si më lartë, sipas Rregullores të Tarifës se Odës se Avokateve, si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit, 79.3, të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se, gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste, në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë. Ndërsa me dispozitën e nenit, neni, 81 të LPK-së, është paraparë se: gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve. Në rastet nga paragrafi i nenit, 79 të këtij ligji i paditësi ka për detyrë të deponoj shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm. Ndërsa me dispozitën e nenit, 449 par. 1 dhe 2 të LPK-së, është përcaktuar se shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor, shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit. Ndërsa me neni, 450 të njëjtit ligj, është paraparë se, secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Gjykata e vënë pran një situatë të tillë, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit: 449.1 dhe 2, 450, 452.1, 453.1 dhe 2, 456.1, 463.1, 142 e lidhur me nenin, 387 të Ligjit të Procedurës Kontestimore LPK- së, vendosi si në të dispozitivit të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C. nr.549/2015 datë, 21.06.2024**

**Gj y q t a r i**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIMI JURIDIK** :Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të të njëjti, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.